



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

NJËSITI PËR MENAXHIMIN E PROJEKTIT “BANIMI SOCIAL ADEKUAT”

Datë: 25.07.2025

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) përmes Njësitit për Menaxhimin e Projektit “Banimi Social Adekuat” (NjMP), bazuar në Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”, Ligjin Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe Memorandumin e Mirëkuptimit për Projektin e Banimit Social Adekuat të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Komunës tuaj, njofton hapjen për:

Thirrje Publike për Aplikim

nën-projektet: “Rinovimi / Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet e Cenueshme” në kuadër të Projektit “Banimi Social Adekuat” në Kosovë

Me këtë njoftim për Thirrjen Publike për Aplikim, bashkëngjiten Formularët e Aplikimit (formati SMART.pdf): “Renovimi i Shtëpive Private për Familjet e Cenueshme” dhe “Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet e Cenueshme” së bashku me Udhëzuesit për plotësim të Aplikacioneve dhe Tabelat e Vlerësimit / poentimit të aplikacioneve (vlerësim nga ana e MMPHI / NjMP).

Meqë këto dy nën-projekte (renovimi dhe rindërtimi i shtëpive private) me plotësim të Formularëve të Aplikimit nga ana e Komunës janë të lidhura ngushtë me përfituesit potencial, MMPHI/NjMP ka përgatitur në mënyrë të unifikuar edhe Thirrjen Publike për Shprehje të Interesit për përfituesit potencial (familjet apo individët e cenueshëm), Formularin e Shprehjes së Interesit – Aplikimin për përfituesit potencial dhe Listën Kontrolluese për verifikim të kushteve të banimit dhe vlerësim të aplikimeve nga ana e Komunës.

- Vlerësimi i Shprehjeve të Interesit për familjet e cënueshme duhet të bëhet nga vet Komuna përmes një Komisioni / NjIP, duke krijuar lisën e ngushtë;
- Pas listës së ngushtë, Komuna përmes Komisionit / NjIP duhet të bëjë verifikimin në terren për të plotësuar dosjen për secilin rast / shtëpi për renovim apo rindërtim;
- Gjatë kësaj faze, por edhe tërë procesit, Komuna / NjIP duhet të diskutoj dhe bashkërendoj me MMPHI / NjIP listën e ngushtë të rasteve të verifikuara dhe parallogarinë preliminare mbi koston e investimit për tërë projektet / shtëpitë për renovim dhe rindërtim;
- Të dhënat nga lista e verifikuar barten në Formularët e Aplikimit (SMART.pdf) për nën-projektet për t'u dorëzuar pranë MMPHI / NjMP së bashku me dokumentet përcjellëse;
- Për shkak të korrektësisë dhe efektivitetit, vetëm pas miratimit nga MMPHI / NJMP të aplikimeve dhe financimit të kërkuar, Komuna mund të shpall rezultatet e shprehjes së interesit për përfituesit përfundimtar të këtyre dy nën-projekteve.

Rinovimi apo rindërtimi i shtëpive private si nën-projekte në kuadër të Projektit Banimi Social Adekuat, janë të parapara dhe lejuara me Marrëveshjen Kornizë të Kredisë si pjesë e Ligjit Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BZHKKE, mirëpo synimi dhe prioritizimi i Projektit të Banimit Social Adekuat është krijimi i më shumë njësive të reja të banimit social për të rritur stokun aktual të Komunave, andaj secila Komunë, e veçanërisht ato të cilat kanë aplikuar dhe nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me MMPHI për më shumë se një nën-projekt, të prioritizojnë nën-projektet brenda interesit të tyre dhe limiteve të financimit të tërësisë së Projektit për tërë Komunitet, si rrjedhojë edhe rinovimi apo rindërtimi i shtëpive duhet të fokusohet dhe zhvillohet ekskluzivisht vetëm për familjet e cënueshme si kategori ekstrem të varfra dhe të varfra që bien në listën e 16 grupeve të synuara të vendosur në formularin e shprehjes së interesit për përfituesit potencial.

- Formularët e aplikimit duhet të plotësohen në mënyrë dixhitale në formatin e programuar SMART.pdf dhe të nënshkruhen. Nënshkrimi në formatin .pdf mund të vendoset edhe në formë të nënshkrimit dixhital.
- Formularëve të plotësuar (dixhital.pdf dhe të printuar) i bashkëngjiten të gjitha dokumentet përkatëse të listuara në faqen e fundit të aplikacioneve (ne format dixhital / të skanuara dhe fizike, të protokolluara në arkivin e Komunës).

Dosja e plotë e aplikimit dorëzohet gjerë me datën 25 Gusht 2025, 08:00 - 16:00h, në format fizik pranë arkivit të MMPHI, ish pallati i mediave "Rilindja" 10000 Prishtinë, si dhe njëkohësisht edhe në format dixhital, në këtë e-mail adresë: drite.m.rama@rks-gov.net

Për të mbështetur Komunën / NjIP-në në plotësimin e Aplikacioneve dhe kompletimin e dokumentacionit të kërkuar, Njësi i Menaxhimit të Projektit (NjMP) pranë MMPHI-së, së bashku me Asistencën Teknike nga WBIF IPF-11 është në dispozicion të plotë dhe në rast nevojë mund të organizohen edhe vizita në Komunë dhe terren.

Për vëmendjen tuaj: para dorëzimit të Aplikacioneve dhe dokumentacionit përcjellës, të diskutohen dhe harmonizohen me MMPHI / NjMP kërkesat e Komunës për financim për këtë

nën-projekt, bazuar në nevojat reale të Komunës dhe kapacitetet financuese të Projektit për të gjitha Komunat.

Mos hezitoni të kontaktoni MMPHI / NjMP për çdo pyetje, paqartësi apo nevojë për ndihmë.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj në këtë fazë të rëndësishme përgatitore të fillimit të zhvillimit të Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve.

.....

Manuali i Implementimit të Projektit “Banimi Social Adekuat” në Kosovë

Gjatë procesit të vendosjes së Sistemit për Menaxhimin dhe Implementimin e Projektit të Banimit Social Adekuat (PBSA), MMPHI me mbështetje të Asistencës Teknike nga WBIF IPF-11, ka përgatitur Manualin e Implementimit të Projektit (MIP) për të përshkruar sistemin dhe procedurat për zbatimin e nën-projekteve. Bashkëngjitur në këtë Thirrje gjeni një fletushkë përmbledhëse – informuese mbi llojet e dokumenteve që përfshihen në kuadër të këtij Manuali, ndërkaq Manuali i plotë me pesë dokumentet e tij përbërëse do të dorëzohet te Komuna / NjIP (në format dixhital) në javët në vazhdim, ku do të zhvillohen edhe sesione e punëtori informuese dhe trajnuese për Njësitet e Implementimit të Projektit në Komuna.

.....

Me respekt,

Njësi i Menaxhimit të Projektit të Banimit Social Adekuat pranë MMPHI